
Shtesa kundërciklike e kapitalit (KUNC) dhe treguesit për caktimin e normës në %

Shtesa kundërciklike e kapitalit (në vijim, KUNC) është një instrument i rëndësishëm makroprudencial, i cili më vete ose i ndërthurur me instrumente të tjera makroprudenciale, ndihmon në ruajtjen e qëndrueshmërisë së sektorit bankar dhe zbut luhatshmërinë në ciklin financiar duke adresuar natyrën ciklike të rrezikut sistematik të lidhur me huadhënien e tepërt.

Zbatimi i KUNC-it për bankat vendase bazohet në rregulloren nr.41, datë 05.06.2019 "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit", dhe në metodologjinë "Për shtesën kundërciklike të kapitalit në Shqipëri" (nëntor 2021). Vendimi i parë i Guvernatorit rreth KUNC-it është ai me nr. 3368, datë 28.06.2019, ku vlera e tij u caktua 0%. Vlera e KUNC-it mbeti në këtë nivel (pra 0%), në të gjitha vendimet tremujore të nxjerra pas kësaj date deri në qershor 2024 kur vlera e KUNC-it u ngjit për herë të parë në nivelin 0.25%.

Vendimmarrja mbi nivelin e shtesës kundërciklike të kapitalit mbështetet kryesisht në ecurinë e vlerave të treguesit të hendekut të raportit të kredisë ndaj PBB-së, i konsideruar ndryshe si treguesi parësor. Megjithëse "hendeku i raportit të kredisë ndaj PBB-së" është treguesi kryesor për aktivizimin e KUNC, praktika e zbatimit të tij në vende të tjera dhe në Shqipëri ka evidentuar ngadalësinë e reagimit të këtij treguesi në përgjithësi, dhe pamjaftueshmërinë e tij për të kapur dhe evidentuar zhvillime të shpejta në segmente të caktuara të kredisë. Ndaj, kuadri rregullator dhe metodologjik i Bankës së Shqipërisë, parashikon që vendimmarrja për përcaktimin e KUNC të mbështetet edhe mbi Treguesin e Paralajmërimit të Hershëm Plotësues (TPHP), ku krahas treguesit parësor përfshihen edhe tregues të tjerë që monitorojnë intensitetin e kreditimit në tërësi dhe në segmente të caktuara të tij.

Arsyetimi mbi caktimin e normës në % të KUNC-it

Vlerat e treguesit parësor kanë vijuar të jenë negative deri në T3-2024, por madhësia e vlerës negative është zvogëluar. Ndonëse treguesi parësor është në nivel që ende nuk sugjeron marrjen e masave makroprudenciale, ecuria e TPHP sugjeron se ky qëndrim nevojitet të rishikohet në kushtet kur rritja e kreditimit ka vijuar në mënyrë të qëndrueshme dhe është më e përshpejtuar në segmente të caktuara të saj. Këto zhvillime sinjalizojnë për vijimin e një situatë me përshpejtim të kreditimit, e cila mund të shoqërohet me akumulim të rreziqeve për cilësinë e kredisë në të ardhmen. Në këtë rast, nevoja për të reaguar në mënyrë kundërciklike me qëllim kontrollimin e rreziqeve, reflekton drejtpërdrejt konceptimin dhe qëllimin e përdorimit të KUNC-it.

Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2024, treguesi parësor regjistron një ngushtim të hendekut negativ (përmirësim të vlerave) për të pestin tremujor në radhë. Vlera e treguesit, është ngushtuar kundrejt të njëjtës periudhë një vit më parë, dhe ndaj tremujorit paraardhës.ⁱ


Tabelë 1. Treguesi parësor

Treguesi parësor ⁱⁱ	Mesatarja historike		T3-2024
	T4-2003 : T4-2008	T1-2009 : T2-2024	
Hendeku i kredisë për ekonominë ndaj PBB-së ⁱⁱⁱ	2.1 pp	-7.96 pp	-6.24 pp ^{iv}

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe INSTAT.

Ecuria e mësipërme reflekton normën më të lartë të rritjes vjetore të kredisë për ekonominë në T3-2024 (rreth 12%), në krahasim me rritjen e prodhimit të brendshëm bruto të vjetorizuar për të njëjtën periudhë (rreth 8%). Treguesi parësor ka regjistruar ngushtim të vlerave të hendekut negativ për segmentin "individë" dhe për atë "biznes". Ky i fundit vijon të japë kontributin kryesor në ecurinë e vlerës së treguesit parësor.

Grafik 1. Ecuria e hendekut të raportit "Kredi për ekonominë / PBB" në pikë përqindje



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Siç mund të shikohet nga grafiku 1, pas T2-2008, ku regjistrohet dhe vlera më e lartë pozitive (4.7 pp), vlerat e treguesit parësor kanë ndjekur kryesisht një trajektore rënëse. Si për bizneset, ashtu edhe individët, është vërejtur një periudhë rënieje e vazhdueshme (zgjerim i hendekut negativ), kryesisht në periudhat 2008-2012 (individët) dhe 2012-2018 (bizneset). Më pas, vlerat e tyre kanë dëshmuar një prirje rritëse, pra hendeku negativ është ngushtuar. Kjo prirje ka qenë më e qëndrueshme në kohë për individët.


Në tërësi, ecuria e vlerës nominale të kredisë për individët (siç raportohet nga bankat) është përcaktuar nga ecuria e kredisë për blerje të pasurive të paluajtshme (për banesa). Rritja e kësaj kredie ka qenë në tërësi më e shpejtë se norma e rritjes së tepërisë së përgjithshme të kredisë dhe më e shpejtë se rritja nominale e PBB-së, dhe si rezultat pesha e saj në raport me PBB-në është rritur prej vitit 2019.

Rritja e kredisë në tërësi, dhe ajo e kredisë për blerje të banesave, është edhe më e fortë në rastin kur korrigjohet për efektin pakësues të (mbiçmimit të) kursit të këmbimit. Siç mund të

Dhjetor 2024

vërehet nga Grafiku 2 (majtas), në fund të shtatorit 2024, rritja vjetore e kredisë, e korrigjuar për efektin e kursit të këmbimit, ishte 17% (në krahasim me vlerën e raportuar prej 12%). I njëjti tregues për kredisë për blerje banesash, ishte 16% (kundrejt vlerës së raportuar prej 12.4%).

Grafik 2. Kredia për pasuri të paluajtshme dhënë individëve dhe hendeku i raportit ndaj PBB-së




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Edhe treguesi i hendekut të kësaj kredisë në raport me PBB-në, i përlogaritur në mënyrë të ngjashme si për treguesin parësor, dëshmon se ky hendek është në vlera pozitive, në mënyrë të qëndrueshme duke filluar prej fundvitit 2023. (Grafik 2, djathtas)

Nëse analizohet ecuria e kredisë që jepet për bizneset, për zhvillim dhe investime në pasuritë e paluajtshme (rezidenciale dhe tregtare), e korrigjuar për efektin e kursit të këmbimit, normat vjetore të rritjes deri në shtator 2024 qëndrojnë mbi 30% në secilin rast. Më tej, nëse agregohen kreditë e dhëna për individët dhe për bizneset, për pasuritë e paluajtshme (rezidenciale dhe tregtare), norma e rritjes vjetore e këtij portofoli shënon 28% (nga 24% sipas raportimit në vlerë nominale). Kjo normë rritjeje është dukshëm më e lartë se norma e rritjes vjetore për të gjithë portofolin e kredisë prej 17%, duke evidentuar përshejtimin e kreditimit.

Rritja e kredisë në 3-4 vjetët e fundit ka vazhduar të jetë e fortë, pavarësisht rritjes së normave të interesit për lekun dhe për valutën. Kjo rritje e normave të interesit, ka qenë e ndjeshme veçanërisht gjatë vitit 2022, dhe është paraqitur e qëndrueshme në vijim.

Grafik 3. Nivelet e normave mesatare të interesit për kreditë e reja.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Dhjetor 2024

Pavarësisht pritjeve, rritja e normave të interesit nuk ka patur një efekt të dukshëm frenues në volumet e kredisë. Në të kundërt, vërehet që flukset e kredisë së re sipas sektorëve, kanë qenë përgjithësisht të qëndrueshëm ose kanë ardhur në rritje (Grafik 4).

Grafik 4. Volumet e kredisë së re.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nëse normat e interesit do të ndalojnë në këto nivele apo do të ndryshojnë drejtim, atëherë do të forcohej mundësia për përsheptim të rritjes së kreditimit.

Rritja e përsheptuar e kredisë përgjatë viteve të fundit, nuk është reflektuar mjaftueshëm në vlerat e treguesit parësor. Vlerat e indeksit ndonëse janë ngushtuar, mbeten dukshëm në territor negativ. Ky fenomen është vënë re edhe në vende të tjera, dhe i atribuohet kryesisht ritmeve të ulëta të kreditimit për një periudhë të gjatë kohe në të kaluarën (kryesisht pas krizës financiare globale 2007-2009).

Por treguesi i paralajmërimit të hershëm plotësues (TPHP) e ka sinjalizuar prej disa tremujorësh këtë ecuri të shpejtë të kredisë. Vlerat e indeksit (aktualisht 0.51) kanë regjistruar vlera mbi kufirin maksimal të përcaktuar në Metodologjinë "Për përcaktimin e shtesës kundërciklike të kapitalit" (0.5), një territor ku kjo metodologji parashikon zbatimin e një vlerë pozitive të KUNC (prej 0.5%).

Grafik 5. Ecuria e Treguesit të Paralajmërimit të Hershëm Plotësues.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në tërësi, zhvillimet pozitive në ciklin financiar reflektohen edhe në treguesit e performancës së sektorit bankar. Ashtu si një vit më parë, edhe përgjatë vitit 2024 sektori vijoi të zgjerojë veprimtarinë, siguroi një cilësi të mirë të aktiveve ku raporti i kredive me probleme zbriti në nivele të ulëta historike (në nëntor 2024, 4.5%), realizoi një rezultat shumë të mirë financiar (ne shtator 2024, RoA 1.9% dhe RoE 18.3%) dhe ruajti nivele të mira të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit (në shtator 2024, 20.2%).

Në funksion të vlerësimeve për ecurinë e ciklit financiar, instrumenti i KUNC-it është përdorur gjerësisht edhe në vendet e tjera të rajonit dhe të Bashkimit Evropian (BE). Kështu aktualisht, në rajonin e Ballkanit Perëndimor, sipas informacioneve të mbledhura në faqet e internetit të bankave qendrore, shtesa e KUNC-it nuk duket se ka filluar të aplikohet në Kosovë dhe në Bosnje-Hercegovinë, është ruajtur në 0% në Serbi, është rritur në 0.5% në **Malin e Zi**¹ (me zbatim nga 1 prill 2025) dhe është rritur në nivelin 1.75% në **Republikën e Maqedonisë së Veriut** (me zbatim nga 1 shtatori 2025). Sipas publikimeve të Bordit Evropian të Rrezikut Sistemik, në vendet anëtare të BE-së, niveli i KUNC aktualisht varion nga 0% në Itali, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Letoni e Poloni; në 0.5% në Slloveni, Belgjike dhe **Hungari**; në 0.75% në Gjermani; në 1% në Francë, Rumani, Qipro dhe Lituani; në 1.25% në Çeki^{**2}; në 1.5% në Irlandë, Sllovakia, Estoni dhe **Kroaci**; në 2% në Hollandë, Bullgari dhe Suedi; në 2.5% në Islandë, Norvegji dhe Danimarkë.

Konkluzion dhe propozimi për normën e KUNC-it

Prej disa tremujorësh, ekonomia shqiptare po përjeton një cikël financiar pozitiv të mbështetur mbi rritjen e përsheptuar të kredisë bankare. Periudha të tilla shoqërohen me nivele të mira të performancës financiare për agjentet e ekonomisë reale dhe për sistemin financiar. Megjithatë, këto periudha shoqërohen edhe me fillimin e rreziqeve të caktuara, që mund të lidhen me rënie të standardeve të kreditimit, rritjen e niveleve të përqendrimit të saj në sektorë apo tregje të caktuara, rritjen e niveleve të borxhit për agjentët e ekonomisë reale përtej niveleve të shëndetshme etj. Këto situata, nëse lejohet të zhvillohen mund ta bëjnë ekonominë dhe sistemin financiar më të ndjeshëm ndaj goditjeve të ndryshme, duke cënuar kështu stabilitetin financiar. Për këto arsye, në këto raste sugjerohet përdorimi i instrumenteve makroprudenciale që zbusin ecurinë e ciklit financiar (veprojnë në mënyrë kundërciklike) dhe parandalojnë zhvillimin e pakontrolluar të këtyre rreziqeve. Ndër këto instrumente, KUNC-i zë një vend të rëndësishëm.

Në rastin tonë, zhvillimet pozitive në ciklin financiar reflektohen tek ngushtimi i vlerave negative të treguesit parësor (hendeku i raportit të kredisë ndaj PBB-së), por edhe më mirë nga ecuria e vlerave të Treguesit të Paralajmërimit të Hershëm Plotësues (TPHP). Mbështetur në vlerat e këtij të fundit përgjatë disa tremujorëve, përdorimi i KUNC-it sugjerohet nga metodologjia "Për përcaktimin e shtesës kundërciklike të kapitalit".

Mbështetur në analizën e treguesve të mësipërm, propozojmë:

¹ Të theksuara, janë shtetet që kanë regjistruar një rritje të KUNC-it që prej Qershorit 2024.

² Të nënvijëzuara, janë shtetet që kanë shënuar një rënie të KUNC-it që prej Qershorit 2024.

Dhjetor 2024

- rritjen e normës së KUNC-it për Shqipërinë me 25 pikë bazë, në nivelin 0.5%. Bankat do të duhet ta plotësojnë këtë shtesë për herë të parë në fund të muajit dhjetor 2025.

Nëse ritmet e kreditimit do të mbeten të larta, mund të priten rritje të tjera të normës së KUNC-it në periudhat e ardhshme.

Fund

SQARIME:

ⁱ Vlera e treguesit parësor ishte: [-8.58] pp në T3-2023, [-8.29] pp në T4-2023, [-7.77] pp në T1-2024 dhe [-6.79] pp në T2-2024.

ⁱⁱ Në analizën e vlerave në tabelë, duhet konsideruar që vlerat e llogaritura të treguesit parësor dhe të mesatares së tij historike, ndryshojnë për shkak të dy grupeve të faktorëve: a) zhvillimeve në vlerat e kredisë për ekonominë dhe të PBB-së; dhe b) rishikimeve të vlerave të PBB-së, që kryen rregullisht Instituti i Statistikave (INSTAT). Këto dy grupe faktorësh mund të ndikojnë mbi vlerën e treguesit parësor, në të njëjtin kah ose në kahe të ndryshme.

ⁱⁱⁱ Vlera e PBB-së është llogaritur si shuma e vlerave të katër tremujorëve të fundit. Vlera e PBB-së për periudhën mund të jetë subjekt rishikimi në periudhën pasardhëse nga INSTAT.

^{iv} Vlera e treguesit parësor për T3-2024 shënon një ngushtim (përmirësim) të hendekut të kredisë në krahasim me vlerën e T3-2023. Në këtë ndryshim ka ndikuar rritja më e lartë e rritjes së kredisë për ekonominë kundrejt produktit të brendshëm bruto të vjetorizuar.